

Një rrafsh i ri i Artit

Është fakt tashmë se gjetjet e fiksuara në drurin e ullirit kanë krijuar një rrafsh të ri të mirëfilltë të artit figurativ. Gjetjet në fjalë, objekte apo ngjarje të fiksuara në trupin e pemës se ullirit, përcjellin mesazhe të caktuara, shkaktojnë emocione të veçanta dhe kënaqësi artistike. Kontaktet e para me këto objekte artistike, që përbëjnë tashmë një rrafsh të ri të artit shkaktojnë një shumësi pyetjesh, të cilat jo të gjitha mund të gjejnë përgjigje, sepse është e vështirë të përfytyrosh zhvillimet e mëtjeshme të këtij zhanri të ri të artit. Por, jam i bindur se sado të ketë pyetje dhe diskutime lidhur me këtë zhaner të ri të artit, do të mbetet i pacënueshem ky konkluzion; krijimi i këtij rrafshi nuk ka qenë asfare rastësi dhe se autori i tij nuk është një person i një standarti të zakonshëm.

Është i njohur aforizmi, formuluar në kontekstin e një “zbulimi të rastsishëm” shkencor, se rastësia viziton njerezit e zgjuar, punëtor dhe me një intuete të fuqishme. Intuita, njohja direkte jo diskursive, jo e mbështetur në një proces meditativ, apo e shprehur thjeshtë, goditja në shenjë pa pasur të dhëna të plota, është kualitet i një personaliteti që karakterizohet nga një meditacion konkludiv, permanent. Nepërmjet këtij procesi ky personalitet arshivon në ndërgjegjen e tij konkluzione të caktuara, të cilat shërbejnë për formimin e instrumentave konceptual, që lidhen ndërmjet tyre dhe përgjojnë me rreptësi çdo perceptim, një përgjim me një element substancial që përmbledhet në devizen: “*kush nuk beson në çudira nuk është realist*”. Në kontaktin e parë me një fenomen të ri ky personalitet nuk çuditet, të çuditësh do të thotë t’i shkëpusish marrëdhëniet me objektin, të largohesh nga ai, duke bartur me vete një perceptim të vagte të tij, por e kategorizon atë një njohje të re të realitetit dhe për të thellimi i kësaj njohje merr statusin e një detyre konkrete. Ky është procesi, besoj une, nëpër të cilin ka kaluar miku im z. M. Trepçi dhe i ka siguruar atij statusin e krijuesit të një rrafshi të ri të artit figurativ.

Dua t’i garantoj lexuesit se hartuesi i këtij shënimi përcjellës për librin “Emocionët e nënës natyrë” nuk është befasar asfare që z. M. Trepçi ka tashmë statusin e krijuesit të një rrafshi të ri të artit figurativ. Ai ka konstatuar dhe ka shijuar gjatë tridhjetë vjeteve të njohjes dhe diskutimeve me të, sentenca logjike, shpesh të formuluar prej tij në menyre aforistike,

produkte të një meditacioni konkludiv, permanent e tejet kualitativ. Por, ai e ka paraqitur fillimisht dhe vazhdimisht punën e tij krijuese të një karakteri të veçantë me rëndësi botërore me një modesti pothuajse të pajustificueshme nga ndrojtja se refleksi i intuitës së tij të fuqishme do të interpretohej si paranojë. Megjithë kritiken time konstante se paraqitja e këtij rrafshi të ri të artit nuk është bërë me formulime që i takonin nivelit të këtij zhanri të ri të artit, ai preferoi t'ja linte vlerësimin më tepër specialisteve të artit në rrafshin nacional dhe internacional. Sidoqoftë, unë si admirues i artit do të perpiqem t'u jap një korpus të prekshëm dhe konkret ndjesive dhe emocioneve të mia lidhur me punimet artistike të impresioneve në drurin e ullirit të z. M. Trepçi të paraqitura në ekspozita dinjitoze të një rëndësie të vecantë në shkallë internacionale.

Çdo vepër e artit figurativ ndërmjetëson një mesazh të paartikulluar, por me një përmbajtje të caktuar semantike, i cili shkakton një emocion pozitiv, që për përceptuesin është një përjetim i një kënaqësie. Sigurisht të gjitha këto ndodhin brenda një konteksti të caktuar social. Artisti ndërmjetëson tek përceptuesi për shijimin e së bukurës që ai e merr nga realiteti. Duhet patjetër të ketë një miratim social të njafuëshëm që një vepër e caktuar të bëhet vepër arti. Pikërisht ketë dua të tematizojë dhe ta problematizojë lidhur me gjetjet artistike, që tashmë janë vepra artistike, të fiksuara tek tungu i pemës së ullirit. Duke punuar me drurin e ullirit vëmendjes të autorit të këtij zhanri të ri të artit figurativ nuk i shpëtojnë figurat disi të vagta të fiksuara aty. Menjëhere intuita e tij e fuqishme i sugjeron në mënyrë të ngulët, se keto paraqesin fiksime figurative të objekteve dhe ngjarje të caktuara njerezore. Për intuiten e tij nuk është asfare e nevojshme të dihet mekanizmi i krijimit tek druri i ullirit i këtyre impresioneve. Natyra me çudirat e saja lexohet nga intuita e tij si një realitet, sepse në arshiven e ndërgjegjes së tij, të ndërtuar nga një meditation konkludiv, përgjon instrumenti i cili ka këtë devize: “kush nuk beson në çudira nuk është realist”¹. Shpejt i rezulton atij, se gjetjet e tija përfaqësojnë objekte që rrezatojnë mesazhe të caktuara dhe shkaktojnë emocione pozitive dhe përjetime që dhurojnë kënaqësi, shkurt: ato përfaqësojnë vepra arti. Ai, pas këtij konkluzioni, vazhdon të punojë me intensitet dhe fillon të shtohet numri i veprave të artit, që tashmë mundësojnë edhe hapje ekspozitash. Por, si cdo lloj arti i caktuar ai duhet të ketë mundësinë e krijimit në vijimësi të veprave artistike, procedurën e realizimit të tij. Kjo ceshtje përfaqëson një aspekt të pashmagshëm diskutimi, i cili duhet të konfirmojnë edhe njëherë forcën produktive të

¹ “Kush nuk beson në çudira, nuk është realist”, në origjinal, në gjermanisht: “wer an die Wunder nicht glaubt, der ist kein Realist”

skepticizmit. Për ta sjellur më afër këtë ide shpejtoj të theksoj, se duke dyshuar se krijimi i këtyre veprave arti të zhanrit të veçantë mbetet rastësi, sepse askush që përpiqet t'i krijojë ato nuk mund të bëhet garant se do t'i kurorëzojë me sukses përpjekjet e tij, apo më pesimiste, se ai do të mund të ndodhet para gërmadhëve të përpjekeve të tija të stërmundishme, bëhet shumë premtues angazhimi për përpunimin e teknikave për realizimin me sukses të kësaj veprimtarie artistike. Fakti që autori i këtij rrafshi të ri të artit figurativ ka tashmë në dispozicion një shumësi vepra të tilla artistike, dëshmon qartë se një gjë e tillë është e mundshme, por jo për të gjithë, por vetëm për shumë pak personalitete, gjë që bën të dukshëm forcën magjepsë të këtij lloji arti, tashmë i shpalosur në mënyrë krejt evidente.

Një çështje thelbësore e kushtëzuar në mënyrë tejet komplekse nga vet specifika e këtij zhanri arti është raporti ndërmjet punës së natyrës dhe mjeshtrisë të artistit për t'i dhënë produktit të përfituar kualitetin artistik. Është fare e qartë se artisti, si kurdoherë, por në këtë lloj arti në mënyrë të veçantë, ka hapësira të konturuara mjaft rreptë, brenda të cilave ai duhet të lëviz, që produkti i punës së tij të mos lëviz nga statusi i veprës artistike. Por edhe këtu, si kudo, veçanërisht në botën e artit, ai duhet të guxojë për të përftuar kualitetin e dëshruar të ambicies së tij. Ai duhet të guxojë për të shpresuar, se ndërhyrja e tij garanton kualitetin të lartë, të dëshiruar, i cili kurdoherë çmohet si vepër arti e nivelit të lartë artistik. Për vetë specifikën e këtij arti ambicia e artisti për produkte kualitative përfaqëson një sfidë, mjeshtrimi i së cilës do të thotë krijimi i një raporti optimal ndërmjet punës së natyrës dhe të artistit. Për produkte artistike në këtë zhaner arti, sipas mendimit tim, ky raport ka statusin e një reference imperative dhe permanente. Duke vështruar produktet që na ofrohen në ekspozitat e z. M. Trepci, vrojtuesi i cili është i familjarizuar disi mirë me këtë lloj arti e ndjen se ky raport jo kudo është i një vlere, i cili me sa duket vjen, se autori në produkte të caktuara nuk ka guxuar në ato nivele si në rastet e tjera. Por, gjithësesi autori nuk mahnitet para pamjes që i ekspozohet gjatë punës dhe guxon. Por edhe autori i këtyre rrjeshtave, ndoshta guxon kur merr përsipër të kualifikojë veprat e ekspozuara, por sidoqoftë kjo demonstroi se sa emocione dhe kënaqësi sjellin këto vepra të mirëfillta arti, që impulsjnë edhe guxime estetike, sepse ato mundësojnë të ndjehet në të gjitha dimensionet e saja aforizmi brilant, se “nuk ka gjë me realiste se utopia”. Pa forcën e utopisë nuk do të kishim mundur të përjetonim sot ato arritje të teknikës informatike dhe se arti ndikon në rritjen e kësaj force aq të domosdoshme për përparimin e njerëzimit.

Është krejt eividente, se bota e artit sot është ndryshe nga ajo e djeshmja, por në kontekstin e rrafshit të ri, që ka krijuar gjetjet e impresioneve tek pema e ullirit, e vërteta se bota e artit ndryshon çdo ditë merr një dimesion të ri. Ka qenë fat për të gjithë ne që i përkasim një kulture të caktuar, që emërtohet dendur kulturë shqiptare, që është anëtar i kësaj pëkatësie autori i këtij rrafshi të ri të artit.

Autori i këtij rrafshi të ri arti dha një provë të re të vërtetësisë të këtij aforizmi brilant europian: *“Kultura është historia jo e ideve, por e njerëzve konkret, të papërsëritshëm”*².

Gjergj Perluca³

² *“Kultura është historia jo e ideve, por e njerëzve konkret, të papërsëritshëm”*, në origjinal, në gjermanisht: *“Kultur ist Geschichte nicht von Ideen, sondern vom konkreten, je einmaligen Menschen”*

Ky aforizëm, shpesh i cituar në Europë, është formuluar nga ish presidenti gjerman Richard von Weizsäcker; DUDEN, Reden gut und richtig halten.

³ Gjergj Perluca , pedagog i fizikes në universitetin e Shkodrës në vitet 1975 – 1997. Hartues, si bashkautor, i disa teksteve mësimore për studentet e fizikës, por edhe për studentë të tjerë të universiteteve shqiptare. Si zhurnalist i lirë ka botuar shumë artikuj në gazeta shqiptare, por edhe të huaja.